

MANUAL PËRDORIMI POS ANDROID

NDEZJA/FIKJA E TERMINALIT POS ANDROID

Për ta ndezur, sigurohuni që bateria e terminalit POS të jetë e instaluar saktë dhe shtypni butonin e ndezjes (butoni i parë në të majtë të terminalit) për 2 deri në 3 sekonda, derisa ekrani të ndizet.

Për ta fikur terminalin, shtypni butonin e ndezjes për më shumë se 2 sekonda derisa në ekran të shfaqet menu-ja e mëposhtme (Fig.1), pastaj zgjidhni Fik.



Modaliteti i Ruajtësit të Ekranit

Një shtypje e shkurtër e butonit të ndezjes për afërsisht 0.5 sekonda do të ndizet dhe fiket ekrani.

SHITJE NORMALE

POS-i pranon karta Visa dhe Mastercard. Leximi i kartës në terminalin POS mundësohet në disa mënyra:

Karta me chip/Pa kontakt (Contactless)/Wallet

HAPI 1: Zgjidhet në ekran monedha

HAPI 2: Zgjidhet në ekran menuja – SHITJE

HAPI 3: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe kryhet konfirmimi me butonin "Pagesë kartë".

Shtypni butonin "Cancel" për të fshirë të gjitha shifrat ose shtypni butonin "Delete" për të fshirë një shifër në të njëjtën kohë dhe shkruani një vlerë të re.

HAPI 4: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:

1-Contactless Karta mbështetet sipër kapakut të letrës


2-Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

3-Wallet

HAPI 5: Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Shitje duke u procesuar/Refuzuar" sipas rastit.

Terminali do të shtypë faturë për tregtarin. Shkëputeni faturën e tregtarit dhe shtypni "OK" nëse është e lexueshme ose shtypni "Riprint" për të riprintuar faturën.

Terminali do të pyesë nëse kërkohet një faturë nga klienti. Zgjidhni "Jo" nëse fatura nuk kërkohet nga klienti, zgjidhni "PO" nëse fatura kërkohet nga klienti. Terminali do të shtypë faturë për klientin. Shkëputeni faturën e klientit dhe shtypni "OK" nëse është e lexueshme ose shtypni "Riprint" për të riprintuar faturën.



SHITJE ME BAKSHISH

Në rast se terminal POS ka të shtuar edhe funksionalitetin e bakshishit, pasi të keni vendosur vlerën/shifrën

(Hapi 3) do vijoni me vendosjen e shumës që klienti dëshiron të vendosi për bakshish

Shtypni butonin "Cancel" për të fshirë të gjitha shifrat ose shtypni butonin "Delete" për të fshirë një shifër në të njëjtën kohë dhe shkruani një vlerë të re.

Vendoset shuma e bakshishit.

Nëse klienti nuk do që të lejë bakshish atëherë klikojmë butonin "Bakshish" dhe në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Shitje duke u procesuar/Refuzuar" sipas rastit.

Shënim: Në rastet e vendosjes së Bakshishit, fluksi i transaksioneve do të vazhdojë si në një "Transaksion Shitjeje" normale.


ANULLIMI I VEPRIMIT

Në POS Credins mund të anulohet vetëm veprimi i fundit.

HAPI 1: Për të kryer anulimin e pagesës së fundit, zgjidhet në ekran menuja – ANULLIM

HAPI 2: Në ekran shfaqet automatikisht veprimi i fundit i kryer në terminal dhe ju duhet të verifikoni katër numrat e fundit të kartës dhe vlerën e faturës të cilën doni të anuloni përpara se të konfirmoni.

HAPI 3: Pasi përfundon procedura printohet fatura sërish në dy kopje dhe në këtë mënyrë konfirmohet anulimi i veprimit. Tek Kopja e Tregtarit mbani nënshkrimin e klientit



RIPRINTIM FATURË

Në POS Credins mund të riprintohen faturat.

HAPI 1: Për të bërë riprintim fature në ekran zgjidhet menuja – "Menuja e printimit"

HAPI 2: Në menu zgjedhim nëse do të riprintojmë transaksionin e fundit apo një të më-përparshëm.

HAPI 3: Për të riprintuar transaksionin e fundit klikojmë "Printo transaksionin e fundit" dhe do të riprintohet automatikisht fatura.

HAPI 4: Për të riprintuar një transaksion që nuk është i fundit klikojmë "Printo një transaksion", përzgjedhim transaksionin dhe klikojmë Konfirmo.

Më pas do të riprintohet automatikisht fatura.

NDËRRIMI I LETRËS

Për të ndërruar rulonin e letrës, hapet kapaku sipër ekranit dhe vendoset një rulon letre i ri duke lënë pak letër jashtë të kapur nga kapaku i POS.

PARA AUTORIZIM

Vini re se ky opsion është i disponueshëm vetëm për lloje të caktuara biznesi. Ju lutemi kontaktoni "Shërbimin ndaj Klientit ne Dege" për më shumë informacion. Veprimi i para-autorizimit përdoret për të mbajtur fillimisht një shumë të caktuar pezull, për ta përfunduar transaksionin në një moment të dytë

HAPI 1: Zgjidhet në ekran monedha

HAPI 2: Në ekran zgjidhet menuja – Transaksione të tjera.

HAPI 2: Zgjedhim "PARA-AUTORIZIM", më pas "Para-Autorizim" dhe kalohet direkt tek vlera për t'u paguar. Menuja e Para autorizimit hapet me password duke vendosur të dhënat e ID së Tregtarit.


HAPI 3: Vendosni vlerën dhe konfirmoni duke klikuar "Pagese karte"

HAPI 4: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:


- 1-Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës
- 2-Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)
- 3-Wallet

HAPI 5: Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Para-autorizim duke u procesuar /Refuzuar" sipas rastit.

Në rast se kartëmbajtësi nuk është present do të ndiqen hapat e mëposhtëm.

Tek Hapi 4: lart në të djathtë klikojmë tek ikona  "Transaksione të tjera" dhe në ekran do ju shfaqet mundësia për të vendosur të dhënat e kartës.

- Vendoset PAN (Numri 16-shifror i kartës)
- Vendoset Muaji/Viti i vlefshmërisë së kartës
- Vendoset CVV – Kodi i sigurisë në pjesën e pasme të kartës
- Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Para-autorizim u krye/Refuzuar" sipas rastit.



PËRFUNDIM SHITJE

Për të realizuar përfundimin e veprimit "Para-autorizim" ndjekim hapat si më poshtë:

HAPI 1: Zgjidhet në ekran monedha (në varësi të monedhës në të cilën është prerë fatura)

HAPI 2: Në ekran zgjidhet menuja – Transaksione të tjera.

HAPI 3: Zgjedhim "PARA-AUTORIZIM", më pas "Autorizim Final" dhe kalohet direkt tek shuma për t'u paguar.

HAPI 4: Vendoset vlera që i duhet mbajtur klientit

HAPI 5: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:

1-Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës

2-Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

3-Wallet

HAPI 6: Vendoset Numri references origjinale

HAPI 7: Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Autorizim final u krye/Refuzuar" sipas rastit.

Në rast se kartembajtësi nuk është present do të ndiqen hapat e mëposhtëm.


Tek Hapi 5: lart në të djathtë klikojmë tek ikona "☰ Transaksione te tjera" dhe në ekran do ju shfaqet mundësia për të vendosur të dhënat e kartës

1-Vendoset PAN (Numri 16-shifror i kartës)

2-Vendoset Muaji/Viti i vlefshmërisë së kartës

3-Vendoset CVV – Kodi i sigurisë në pjesën e pasme të kartës

4-Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Autorizim final u krye/Refuzuar" sipas rastit.



MANUAL ENTRY

Opsioni Manual Entry, vendosja e të dhënave manualisht, pa praninë fizike të kartës gjatë kryerjes së transaksionit.

HAPI 1: Zgjidhet në ekran monedha

HAPI 2: Zgjidhet në ekran menuja – Transaksione të tjera

HAPI 3: Zgjidhet në ekran menuja – Transaksion Mail Order (MOTO). Menuja Mail Order hapet përmes password duke vendosur të dhënat e ID së tregtarit.


HAPI 4: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe më pas klikojmë butonin “Pagese karte”

HAPI 4: Vendoset PAN (Numri 16-shifror i kartës) dhe konfirmohet me butonin jeshil

HAPI 5: Vendoset Muaji/Viti i vlefshmërisë së kartës

HAPI 6: Vendoset CVV – Kodi i sigurisë në pjesën e pasme të kartës

HAPI 7: Në ekran shfaqen mesazhet informuese “MOTO duke procesuar me sukses/Refuzuar” sipas rastit.



SHITJE ME KËSTE

Mundësia e blerjeve me këste është vetëm për kartëmbajtësit të kartave të kreditit Credins.

HAPI 1: Zgjidhet në ekran monedha

HAPI 2: Zgjidhet në ekran menuja – Keste

HAPI 3: Vendoset vlera

HAPI 4: Futni numrin e kësteve

HAPI 5: Në ekran shfaqet “Kaloni kartën”. Karta kalohet në tre mënyra:

1-Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës

2-Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)

3-Wallet

HAPI 6: Në ekran shfaqen mesazhet informuese “Blerja u krye me sukses/Refuzuar” sipas rastit.

MBYLLJA DITORE

Mbyllja ditore duhet të realizohet në fundin e çdo dite nëse të paktën keni kryer një transaksion në POS Credins. Ky veprim zeron të gjitha veprimet e kryera atë ditë në POS.

Ky proces kryhet automatikisht dhe manualisht. Procesi automatik kryhet pa nderhyrjen e tregtarit.

Ndërsa për të bërë mbylljen ditore manualisht ndiqen hapat e mëposhtme:


HAPI 1: Klikojmë Menu-në lart të majtë

HAPI 2: Klikojmë Shlyerja

HAPI 3: Vendosim fjalë kalimin

HAPI 4: Zgjedhim nëse do të printojmë Mbylljen ditore të detajuar apo të përmbledhur.

HAPI 5: Printohet Mbyllja ditore.



Problematikat me terminalin POS Android

- Terminali nuk ndizet
- Lidhni terminalin me furnizimin me energji.
- Kontrolloni baterinë (a është shkarkuar? A është e lidhur?)
- Një bateri e shkarkuar plotësisht mund të kërkojë një kohë të gjatë karikimi për t'u rikuperuar.

NËSE POS SHFAQ PROBLEM ME PRINTIMIN E FATURAVE, KONKRETISHT:

└ Fatura printohet bosh:

Ka një gabim në vendosjen e letrës. Letra mund të jetë vendosur mbrapsht ose kapaku nuk është mbyllur plotësisht. Ruloni letër nuk mund të jetë i përshtatshëm për POS (nga madhësia/cilësia e letrës).

Me poshte do te gjeni specifikimet per letren qe duhet te perdoret ne POS Android DX8000:

Lloji i letres : Leter termike

Gjerësi e letres : 58mm

Gjatesia e letrës : 15 metra

Trashësia e letrës : 48µm

└ Letra mbaron gjatë printimit të faturës së veprimit të kryer.

Pasi keni vendosur letrën e re në ekran zgjidhet menuja – RIPRINTIM, për të marrë faturën e veprimit të kryer.

└ Nëse në faturë printohen letrat përgjysëm dhe nëse aparati nuk nxjerr fare faturë.

Kontakttoni në numrat e suportit të vendosur në pjesën e pasme të POS.

└ Nëse në POS dalin fatura me mesazhin "refuzuar" përkatësisht me kodet: [076] Fonde të pamjaftueshme.

Klienti nuk ka fonde mjaftueshëm në kartë për të blerë produktin/shërbimin.

